



RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SENATIT AKADEMIK TË SHLP MESDHETARE E SHQIPËRISË

Në bazë të nenit 15 të Statutit të SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, Senati Akademik i SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, në mbledhjen e datës 11/03/2015 miratoi:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SENATIT AKADEMIK

I. Dispozita të përgjithshme

Me anë të kësaj Rregulloreje rregullohet përbërja, mandati, thirrja dhe organizimi i mbledhjeve, drejtimi i mbledhjes, format e vendimmarrjes, kompetencat e Senatit Akademik të Institucionit, formimi i Komisioneve dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me punën e Senatit.

Neni 1

1. Senati akademik i SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është organ kolegjal vendimmarrës.
2. Senati akademik shqyrton problemet më të rëndësishme të institucionit në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
3. Të drejtat dhe kompetencat e Senatit akademik janë përcaktuar në Statutin e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë.

Neni 2

2.1 Senati akademik I SHLP Mesdhetare e Shqipërisë përbëhet nga së paku 9 anëtare ku përfshihen:

- a) Rektori i SHLP Mesdhetare e Shqipërisë
- b) Dekanët e Fakulteteve;
- c) një përfaqësues i caktuar nga Qendra “Mesdheu”, me status akademik;
- d) një përfaqësues i studentëve;
- e) përfaqësues te personelit mesimor shkencor te zgjedhur nga departamentet.

2.2 Rektori është kryesues i Senatit akademik.

2.3 Në mungesë të Rektorit, mbledhjen e Senatit akademik e kryeson një nga anëtarët i cili autorizohet me shkrim nga ana e Rektorit.

Neni 3

3.1 Mandati i Senatit është 4 vjeçar.

3.2. Mandati i anëtarit të Senatit merr fund: (a) me mbarimin e afatit të mandatit; (b) kur jep dorëheqjen; (c) me largimin nga Institucioni.

3.3 Në këtë rast bëhet zëvendësimi i anëtarit të larguar me anëtar të ri, perkundrejt te njejtave procedura dhe me kohezgjatje sa pjesa e mbetur e anetarit te cilin ai zevendeson dhe me te drejte rizgjedhjeje. Zevendesimi i anetarit behet brenda një muaji.

Neni 4

4.1 Senati mblidhet në seanca të zakonshme të paktën një herë në tre muaj me kërkesë të Qendrës Themeluese. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me një rend të caktuar dite: (a) me nismën e Rektorit, (b) me kërkesë me shkrim nga 1/3 e anëtarëve të tij.

4.2 Thirrja me shkrim bëhet nëpërmjet fax-it ose e-mail, duke iu dërguar anëtarëve së paku 15 ditë më parë nga data e fiksuar për mbledhjen, duke iu bashkëlidhur edhe rendi i ditës.

4.3 Rendi i ditës propozohet nga Rektori.

Neni 5

5.1 Mbledhja e Senatit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se 2/3 e anëtarëve të Senatit.

5.2 Mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet në ambientet e Institucionit, përveç se në rastet kur Qendra Themeluese vendos ndryshe.

5.3 Mbledhjet e Senatit akademik janë të hapura, përveç rasteve kur Rektori vendos ndryshe.

Neni 6

- 6.1 Vendimet e Senatit merren me shumicën e thjeshtë të votave (50%+1), të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statutin e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë dhe në këto rregullore.
- 6.2 Për shprehjen e mendimit kolegjal lidhur me shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme.
- 6.3 Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës, pa patur të drejtë ta delegojë atë.
- 6.4 Në rastet kur ka barazim në votim, Kryesuesi i Senatit akademik ka një votë shtesë.
- 6.5 Rektori ka të drejtën e vetos pezulluese mbi vendimet e Senatit duke i kthyer edhe një herë për shqyrtim, kur nuk është dakord me to.

Neni 7

Kompetencat e Senatit akademik janë:

- a) Garanton respektimin e parimeve të autonomisë, lirisë akademike e të kërkimit si dhe të drejtat e studentëve;
- b) Miraton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- c) Miraton Projekt Buxhetin e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, të përgatitur nga Rektori dhe ja paraqet për miratim sipas kompetencave Qendrës Mesdheu;
- d) Përcakton politikën e drejtimit e zhvillimit e të perspektivës të SHLP Mesdhetare të Shqipërisë në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës e të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit;
- e) Shqyrton e miraton projektin e Statutit të SHLP Mesdhetare e Shqipërisë me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
- f) Miraton rregulloret e institucionit, që janë kompetencë e tij dhe mbikqyr zbatimin e tyre;
- g) Miraton programet e studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre, në kuadër të hapjes/përshtatjes apo riorganizimit të tyre, si dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;
- h) Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës;
- i) i propozon Rektorit kërkesën ndaj Këshillit të Akreditimit për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e kurseve të studimit dhe të strukturave akademike apo të vetë institucionit;
- j) i propozon Rektorit normat vjetore të ngarkesës mësimore për personelin akademik;

- k) i propozon Rektorit kuotat e pranimeve të studentëve në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë dhe kuotat e bashkefinancimit;
- l) miraton nëse do të ketë kritere pranimi në ciklet e studimeve dhe nëse do të ketë cilat do të jenë ato, mbështetur në këshillat e fakulteteve;
- m) mund të propozojë ngritjen e grupeve të punës për probleme të veçanta;
- n) i propozon Rektorit kriteret për dhënien e bursave të studimit për kategori të veçanta studentësh. Akordimi i bursave bëhet me propozim të rektorit dhe me miratimin e Qendrës Themeluese;
- o) shpreh mendim dhe formulon propozime mbi të gjitha çështjet që ligjërisht i propozon Rektori me thirrjen dhe rendin e ditës.

Neni 8

- 8.1 Senati akademik propozon ngritjen e grupeve të punës/komisione të përhershme dhe ad hoc, për çështje të veçanta me miratimin e Qendrës Themeluese.
- 8.2 Këto grupe pune/komisione janë organe ndihmëse të Senatit dhe veprojnë në përputhje me Statutin e institucionit.

Neni 9

- 9.1 Senati akademik nxjerr rekomandime, propozime dhe dokumente të tjera të natyrës këshillimore të cilat sipas specifikave me miratimin e Rektorit dhe/apo Qendrës Themeluese, marrin formën e vendimeve, urdhërave, akteve dhe dokumenteve të tjera zyrtare.
- 9.2 Mbledhjet e Senatit akademik dokumentohen dhe arkivohen në Arkivën e Institucionit. Mbajtësi i procesverbalit të mbledhjeve të Senatit akademik përcaktohet nga Rektori.
- 9.3 Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
 - rendin e ditës;
 - listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;
 - të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
 - shënimet thelbësore mbi mbledhjen;
 - dokumentet shtesë që duhet t'i bashkangjiten procesverbalit.

9.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Rektori si kryesues i Senatit akademik dhe mbajtësi i procesverbalit.

II. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Kjo Rregullore shfuqizon të gjitha dispozitat e rregulloreve paraprahe që rregullojnë çështjet që i përfshin kjo Rregullore.

Neni 11

11.1 Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përgjegjës është Senati.

11.2 Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bën Qendra Themeluese.

Neni 12

12.1 Rregullorja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Senatit.

12.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së miratimit.

12.3 Iniciativën për ndryshimet e Rregullores e ndërmerr Kryesuesi i Senatit akademik ose 1/3 e anëtarëve të Senatit akademik me miratimin e Qendrës Themeluese.

Tiranë, më __/__/2015

**SENATI AKADEMIK
I SHLP MESDHETARE E SHQIPËRISË**

**K R Y E T A R I
Prof. Asoc.Dr. Nexhmi DUMANI**